

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti për Krime të Rënda**, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Beqir Kalludra, kryetar, dhe gjyqtarët profesionistë Suzana çerkini dhe Vehbi Kashtanjeva, anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit Arianit Mahmutaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.V, për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së shtetit, PP.nr.439-5/10 të dt.11.12.2014, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me dt.22.11.2016, në të cilën kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Ilaz Beqiri dhe i akuzuari, të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht këtë:

### A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit **S.V**, i biri i M, dhe nënës D, e gjinisë K, i lindur me dt.*data e lindjes*, në P, tani me vendbanim në P, rr.D Su ./., i shkurorezuar, baba i 2 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, malazez, shtetas i Republikës së Kosovës. Me letërnjoftim nr. *Numri letërnjoftimit* i Republikës së Kosovës.

**Refuzohet Akuza** për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 lidhur me nenin 23 të KPK-së, për shkak të tërheqjes së prokurorit të shtetit nga akuza, gjatë shqyrtimit gjyqësor, konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate, në bazë të nenit 454 par.1 të KPRK-së.

I dëmtuari Sh.H, nga P, lagjja e S, rr.'P'' pn., ka heq dorë nga paraqitja e kërkesës pasurore-juridike konform nenit 461 të KPPRK-së.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, kundër të akuzuarit S.V ka paraqitur aktakuzë PPr. 439-5/10 të dt.11.12.2014, për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar mirë, se i njëjti ka kryer veprën penale si në hyrje të këtij aktvendimi.

Lidhur me këtë çështje penale, Gjykata ka caktuar disa seanca të shqyrtimit gjyqësor, dhe në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor të dt.22.11.2016, pas dëgjimit të dëshmitarëve dhe të dëmtuarit, prokurori i shtetit ka hequr dorë nga akuza kundër të akuzuarit S.V për veprën penale për të cilën është akuzuar.

Andaj bazuar në parimin akuzator, në një gjendje të tillë të fakteve, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për refuzimin e akuzës kundër të akuzuarit S.V, konform nenit 363 par.1 nënpar.1.1 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me shpenzimet e procedurës penale është marrë, duke pas për bazë faktin se kundër të akuzuarit është refuzuar akuza, konform nenit 454 par.1 të KPRK-së.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore-juridike është marrë konform nenit 461 të KPPRK-së, kjo për faktin se i dëmtuari ka hequr dorë nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 363 par.1 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti për Krime të Rënda  
PKRnr.626/14, dt.22.11.2016

**Procesmbajtësi**  
Arianit Mahmutaj

**Kryetari i trupit gjykues - gjyqtari**  
Beqir Kalludra

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa  
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve  
nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.